



## OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PARAPRAK)

Data 13.11.2024

Drejtuar: **“DRIVE EXPERT ALBANIA” sh.p.k**

*Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Njesia Bashkiake Nr.7, Pallati G&P, kati 1, Tiranë*

\* \* \*

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-21645-09-25-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr.1060 Babrru”, me afat të marrëveshjes kuadër 48 (dyzet e tetë) muaj, me fond limit të marrëveshjes kuadër 47,896,000 (dyzet e shtatë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë pa TVSH, ose 483,895.74 (katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë pikë shtatëdhjetë e katër) Euro pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.65 datë 30.09.2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

**1. “DRIVE EXPERT ALBANIA” SH.P.K**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**L720170210**

*numri i NIPT-it*

Vlera: 37,715,000 (Tridhjetë e shtatë milion e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

**2. BOE “EJSEL” SH.P.K**

**M31401012L**

**&**

**“APOSTOL PAPA” P.f**

**L52104119N**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera: 46,544,000 (dyzet e gjashtë milion e pesëqind e dyzet e katër mijë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

**1. BOE “EJSEL” SH.P.K**

**M31401012L**

**&**

**“APOSTOL PAPA” P.F**

**L52104119N**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Operatori ekonomik BOE “EJSEL”sh.p.k, me NUIS M31401012L & “APOSTOL PAPA” P.f me NUIS L52104119N, është skualifikuar si më poshtë:

Nuk plotëson pikën 2.2.1, të seksionit 2.2 “Kapaciteti financiar”, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT, lidhur me vlerën e xhiros vjetore në tre vitet e fundit financiare(2021,2022,2023), për këto asrye:

- Për vëretimin e kësaj pike antari i BOE Ejsel sh.p.k ka paraqitur një vërtetim xhiro T11669019 dt.18.10.2024 ku pasqyrohet se në vitin 2023 ka realizuar xhiro financiare në vlerën 6,747,785 lekë. KVO konstaton se kjo vlerë nuk e plotëson kushtin për nivelin financiar të kërkuar për anëtarin e BOE në raport me përqindjen e deklaruar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit. Konkretisht në DT është kërkuar realizim i xhiros financiare në të paktën 1 vit jo më të vogël se vlera e fondit limit në një vlerë jo më pak se 47,896,000 lekë, vlerë e cila në rastin e antarit BOE Ejsel sh.pk duhet të ishte 29% FL = 13,889,840 lekë. Pra vlera e realizuar në tre vitet e fundit (2021,2022,2023), në të paktën 1 vit është 6,747,785 lekë dhe është me e vogël se vlera e kërkuar. Në lidhje me Shkresën nr.21441 dt.25.10.2024 të Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve ku përcaktohet se subjekti për muajt Janar-Shtator 2024 ka realizuar xhiro financiare prej 13,953,543 lekë. KVO gjykon se ky dokument nuk mund të përfshihet në shqyrtimin për kualifikim sipas pikës 2.2.1, për arsye se në Dokumentat e Tenderit specifikohet qartë detyrimi që vërtetimi për xhiron duhet ti referohet xhiros në vitet financiare (2021,2022,2023) dhe kërkesa nuk ka klauzolë apo parashikim për vitin korrent të aktivitetit 2024, vit i cili nuk është përmbyllur dhe certifikuar nga ana financiare. Ky arsyetim përvec referimit në Dokumentat e Tenderit, mbështetet në parashikimet e nenit të VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros

*minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor”, që do të thotë se KVO duhet ti referohet vetëm peridhes së kërkuar në Dokumentat e Tenderit.*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm është identifikuar si fitues (paraparak) të procedurës së prokurimit:

**1. “DRIVE EXPERT ALBANIA” SH.P.K**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**L720170210**

*numri i NIPT-it*

Vlera: 37,715,000 (Tridhjetë e shtatë milion e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit, sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**